

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTERIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT MINISTARSTVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT	
Njësia Org. Org. Jedin Org. Unit Nr. i fagava Broj stranica No. pages	Nr. Prof. Dr. Prof. Prof.No: Data: Datum: Date:
01/3 4 PRISHTINË/A	1879 28.10.20 NO.1



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
 Kosova Landfill Management Company J.S.C
 Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishte, 10000 Prishtinë, Kosovë
 Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
 www.kmdk-ks.org

KMDK. SH.A KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD	
Nr.	01-68/5
Dt.	27/10/2020
Prishtinë	

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Në bazë të nenit 20 të ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në bazë të nenit 29 të po këtij ligji, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, në përputhje me Dispozitat e Nenit 12, të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, në bazë të Nenit 16 të Ligjit Nr. 06/L-105 Për Tatime në të ardhurat e Korporatave, në bazë të Udhëzimeve nga Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK), në bazë të nenit 20.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë të nenit 7 të Statutin të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A, Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datën 23.10.2020 miraton këtë:

RREGULLORE NR. 22/2020 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 16/2018 PËR MENAXHIMIN E PASURISË NË KMDK SH.A

NENI 1

1.Neni 39, (Baza juridike për vlerësimin e pasurisë) Paragrafi 1, Pika 1 i Rregullores bazike riformulohet si në vijim;

1.1 Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përkatësisht Neni 7.

NENI 2

1. Neni 49, (Zhvlerësimi i Pasurive) Paragrafi 3 dhe 4 i Rregullores bazike riformulohet si në vijim;

Paragrafi 3

E gjithë prona e prekshme e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas këtij neni, klasifikohet në njërën prej kategorive vijuese:

3.1. Kategoria 1 - ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;

3.2. Kategoria 2 - automobilat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobilet dhe pajisjet për zyra,

HM

instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë, dhe bagëtitë e shfrytëzuara për prodhim ose për mbarështim dhe sektorët e ri në DS dhe investimet në infrastrukturë.

3.3. Kategoria 3 - uzinat dhe makineria; inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që shfrytëzohen për transportin hekurudhor; aeroplanët; anijet, bimët shumë vjeçare dhe bimët e shfrytëzuara për vreshtari ose për prodhimin e frutave; dhe të gjitha asetet e prekshme që nuk janë përfshirë në kategorinë 1 apo kategorinë 2 të këtij paragrafi.

Paragrafi 4

4. Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme në mënyrë individuale të pronës së prekshme individuale, sipas metodës lineare në fund të periudhës tatimore sipas kategorisë së cilës i përkasin asetet:

4.1. Kategoria 1- pesë përqind (5%);

4.2. Kategoria 2- njëzet përqind (20%); dhe

4.3. Kategoria 3- dhjetë përqind (10%).

NENI 3

1. Në kuadër të Rregullorës bazike shtohet Kapitull i ri si në vijim;

PËRGJEGJËSIA MATERIALE E PUNËTORËVE DHE PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E DËMIT MATERIAL

NENI 4

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

1. Punëtori është përgjegjës për dëmin të cilin e shkakton me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë.
2. Nëse dëmin e shkaktojnë më shumë punëtor secili prej tyre është përgjegjës për pjesën e dëmit të shkaktuar.
3. Nëse nuk mund të përcaktohet pjesa e dëmit të shkaktuar, secili punëtor i involvuar në rast do të konsiderohet se është përgjegjës në mënyrë të njëjtë dhe se dëmin duhet kompenzuar në pjesë të njëjta.
4. Dëmin e shkaktuar në rrethana në të cilat është shkaktuar dëmi, lartësinë e saj të shkaktuar, në KMDK SH.A, e përcakton Komisioni për konstatimin e dëmit.
5. Nëse punëtori refuzon të kompenzojë dëmin e përcaktuar ndaj punëtorit ngritet procedurë pranë gjykatës kompetente për kompenzim e dëmit.

NENI 5

Paraqitja e dëmit

1. Secili punëtor është i detyruar të paraqesë dëmin materjal të krijuar dhe kryesin e tij në afat prej 8 ditë , nga dita e njoftimit për dëmin dhe kryesin.
2. Fletëparaqitja bëhet në formë të shkruar tek përgjegjësi i drejtëpërdrejt.
3. Fletëparaqitja për dëmin material të shkaktuar përmban :
 - a) Emrin dhe mbiemrin e punëtorit i cili ka shkaktuar dëmin,
 - b) Mjetet materiale të cilat janë dëmtuar dhe
 - c) Rrethana nën të cilën është shkaktuar dëmi.
4. Kryeshefi Ekzekutiv me vendim inicon procedurën për përcaktimin e dëmit material menjëherë pas pranimit të fletëparaqitjes mbi dëmin e shkaktuar ose pas njoftimit për dëmin e shkaktuar dhe kryesin.
5. Vendimi, nga paragrafi paraprak i këtij neni, i bashkangjitet fletëparaqitja dhe dëshmi të tjera për kryesin e dëmit.

NENI 6

Përcaktimi i dëmit

1. Komisioni për përcaktimin e dëmit material është i obliguar që menjëherë, e më së voni në afat prej 3 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit për iniciimin e procedurës për përcaktimin e dëmit material të fillojë përcaktimin e dëmit.
2. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash.
3. Komisioni është i obliguar të dëgjoj punëtorin, të cilit i vëhet në barrë dëmi material i shkaktuar dhe nxjerr të gjitha dëshmitë (provat) të cilat i propozon punëtori që ka shkaktuar dëmin.
4. Lartësia e dëmit materjal përcaktohet në bazë të çmimoreve aktuale në treg.
5. Në procedurën e përcaktimit të dëmit material Komisioni duhet të përpiloj procesverbal , i cili ka karakterin e dokumentit publik.
6. Kur Komisioni përcakton se punëtori është përgjegjës për dëmin material të shkaktuar , merr Rekomandim nga KE lidhur me të.
7. Kundër vendimit të komisionit për përcaktimin e dëmit material, punëtori mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, në Komisionin e Ankesave pranë KMDK-së.

NENI 7
Kompenzimi i dëmit

1. Nëse punëtori pranon të kompenzoj dëmin në procedurën për përcaktimin e dëmit atëherë me punëtorin nënshkruhet marrëveshje jashtëgjyqësore ku caktohet afati, mënyra dhe kushtet e kompenzimit të dëmit.
2. Me pëlqimin e punëtorit, dëmi i përcaktuar nga Komisioni mund të paguhet nga të ardhurat personale të punëtorit.
3. Nëse dëmin e kanë shkaktuar më shumë punëtor , kurse Komisioni nuk ka mundur të përcaktoj sa ka qen ndikimi i secilit punëtor në dëmin e shkaktuar , Komisioni merr vendim që dëmi të kompenzohet në pjesë të njejta (barabarta).

Prishtinë, Tetor 2020

Mentor Hoxhaj

Kryesues i Bordit të Drejtoreve në KMDK SH.A

